

Drita Xhemaili, PhD¹

UDC:

811.18'271.1-053.2-057.56(430)

**INTERFERENCA SI BURIM I GABIMEVE GJUHËSORE TE
FËMIJET E PUNËTORËVE SHQIPTARË NË GJERMANI**

**ИНТЕРФЕРЕНЦИЈАТА КАКО ИЗВОР НА ЈАЗИЧНИ ГРЕШКИ
КАЈ ДЕЦАТА НА АЛБАНСКИТЕ РАБОТНИЦИ ВО
ГЕРМАНИЈА**

**LANGUAGE INTERFERENCE AS A SOURCE OF LANGUAGE
MISTAKES TO CHILDREN OF ALBANIAN WORKERS IN
GERMANY**

Abstract

The main object of this research study paper is the comparative analysis between the Albanian language and the German language based on linguistic interference in the morpho-synthetic and lexical field. This paper aims to contrast and analyze typical errors of language interference in using and learning the German language under the influence of the Albanian language. Namely, it is about the impact of the mother tongue (Albanian) in the second language (German), but the dilemma is that the Albanian children who grow up and are educated in another country (in our case study is Germany) use German language who they use and feel like it's their mother tongue. The research is based on theoretical and empirical research to date in the field of linguistics by taking into account the interfering errors that these children do when using the German language. This paper deals with the impact of native language (Albanian) on learning or using German language in Albanian children which parents work in Germany, on the

¹ Universiteti “Shën Cirili dhe Metodi” Shkup, Fakulteti i Filologjisë, (drita_xhemajli@hotmail.com)

basis of scientific research, we will try to define the incorporation of mother tongue as a scientific definition.

Key words: language interference, mother tongue, children of Albanian workers, Germany.

Hyrje

Në Gjermani tani më jetojnë dhe punojnë gjenerata e tretë e punëtorëve shqiptarë të cilët kanë migruar apo kanë shkuar në vitet e 60-ta si punëtor krahu të cilët në atë kohë u quajtën Gastarbeiter². Duke e marrë për bazë se gjuha është mjet komunikimi për njerëzit dhe karakterizohet me përdorimin e simboleve arbitrare të folura ose të shkruara me kumtim të caktuar atëherë shtrohet pyetja si qëndron situata me gjuhën amtare shqipe mu te këta fëmijë të cilët janë lindur, rritur dhe shkolluar në Gjermani, me një kulturë dhe me një gjuhë tjetër të dytë? Çka nënkuptojmë me termin gjuhë amtare dhe sa ndihen të sigurt dhe kompetent fëmijët e punëtorëve tanë jashtë vendit me theks të veçantë, atyre që jetojnë dhe punojnë në Gjermani, gjatë përdorimit të gjuhës amtare shqipe dhe asaj gjermane. Në cilin rrafsh gjuhësor paraqiten pengesat dhe pasiguritë? A është interferenca gjuhësore pengesë e përdorimit të gjuhës amë, e kështu me radhë.

Duke u nisur nga rëndësia e temës në fjalë të studimeve dhe hulumtimeve shkencore sociolinguistike në dy dekadat e fundit të këtij shekulli do të përpiqemi ti paraqesim pikëpamjet tona në rrafshin lingvistik duke përfshi dallimet gjuhësore të shqipes dhe gjermanishtes në aspekt morfosintaksor dhe leksik. Ky studim ndryshon nga punimet tjera për faktin se bëhet fjalë për fëmijë që kanë lindur, janë rritur dhe shkolluar në Gjermani dhe gjuhë amtare e kanë gjuhën shqipe që e mësojnë në familje deri në moshën parashkollore. Ndryshimet dhe përkimet midis këtyre gjuhëve reflektohen dhe lënë gjurmë në vetëdijen e folësve shqiptarë, të cilët ndodhen nën trysinë e këtyre dy gjuhëve dhe dy kulturave.

Përkufizimi ose përcaktimi i termit gjuhë amtare

Prosperiteti dhe përdorimi i gjuhës janë të lidhura në mënyrë të pashmangshme me mënyrat individuale të jetës biografike, të cilat janë

² Termi Gastarbeiter do të thote punëtor që punon për një kohë të kufizuar në një vend të huaj. Shih Duden Online: <https://www.duden.de/Shop/Duden-Deutsches-Universalwörterbuch-3?eqrecqid=15c3a8c2-2c20-11e8-94e7-c8600054c192.;> (shikuar më 20.03.2018)

të përfshira në kontekste specifike sociale dhe shoqërore. Sipas Rrokaj (2007) cituar nga Sinanaj (2016: 9) veçanësia e një gjuhë me një tjetër, krahas dallimeve të njohura, qëndron edhe në faktin se çdo gjuhë përfaqëson në mënyrë shumë origjinale mënyrën se si pjesëtarët e bashkësisë folëse perceptojnë marrëdhëniet e gjithanshme, nga ato ekzistenciale deri në ato etnokulturore. Vetëm në gjuhën e tyre vlerat shpirtërore të një populli gjejnë mënyrën më të mirë të shprehjes, sepse ato nuk janë krijuar jashtë kësaj gjuhe. Prandaj me të drejtë shtrohet pyetja, çka nënkuptojnë shkencëtarët me definicionin gjuhë e nënës? Sipas Ammon (2000: 477) termi gjuhë e nënës mund të kuptohet në mënyra të ndryshme. Gjuha e nënës është:

(1) Gjuha e nënës është atëherë kur një individ deklaron se është gjuhë amtare, gjë që mund të jetë edhe nëse nuk e flet fare këtë gjuhë (gjuha amtare sipas rrëfimit).

(2) Gjuha e mësuar gjatë rrjedhës së historisë së jetës, të cilën individi nuk duhet ta pranojë si gjuhë të nënës dhe që mund të mos jetë e zotëruar mirë (gjuha e parë).

(3) Gjuha më e mirë e përvetësuar në momentin e marrjes në pyetje, e cila as nuk mësohet biologjikisht, as nuk është gjuhë amtare (gjuha të cilën e zotëron më se miri).

(4) Gjuha e preferuar në sferën private, veçanërisht brenda familjes, e cila për këtë arsye nuk plotëson kushtet dhe kriteret e mësipërme prej (1) deri (3), në disa raste asnjëra prej tyre (gjuha kryesore komunikuese).

Përkundër përkufizimit dhe ndarjes së Amman (2000) i cili e përkufizon termin gjuhë amtare sipas rrëfimit, si gjuhë e parë e zotëruar apo gjuha të cilën e zotëron më së miri individi si dhe gjuha kryesore komunikuese, Peterson (2015: 6) del me dyshimin se edhe termat e përditshëm si gjuha amtare duhet të merren parasysh nëse merreni shkencërisht me gjuhën dhe migracionin, sepse edhe nëse ky term duket i qartë dhe i padëmshëm, është pothuajse e pamundur të përcaktohet. Kjo çështje qendrore nuk është e lehtë për t'u përgjigjur, sepse në literaturë ka dallime thelbësore të mendimeve lidhur me nocionin e definicionit të gjuhës amtare që në gjuhën gjermane d.m.th. '*Muttersprache*'. Tani lind pyetja cilën gjuhë e flasin dhe e ndjejnë fëmijët e punëtorëve shqiptarë në Gjermani si gjuhë amtare atë shqipe apo gjermane? Rreth kësaj problematike në rrafshin shkencor Ferguson (1959) cituar nga Dittmar (1980: 390) sjell termin diglosi, që nënkupton "një situatë relativisht të qëndrueshme gjuhësore me dialektet primare rajonale,

varietetin L dhe një variant të mbivendosjes së gjuhës, varietetit H". Por ndërkohë që një variant i lartë (high-Varante) shoqërohet me prestigj, një variant i ulët (low-Variante) shpesh konsiderohet si variant i gjuhës verbale dhe përcaktohet nga informaliteti. Sipas Lüdi (1984: 12) me termin diglosi nënkuptojmë:

“Situation einer sozialen Gruppe (Familie, Volk, Stadt, Region u.ä.), welche sich zu einem gegebenen Zeitpunkt zur Erfüllung ihrer kommunikativen Bedürfnisse aus welchen Gründen auch immer zweier oder mehrerer sprachlicher Varianten (Sprachen, Dialekte usw.) mit einer regelmäßigen Rollenaufteilung bedient.“³

Sipas këtyre definicioneve nga shkencëtarët e lartpërmendur për gjuhën amtare mund të konstatojmë se gjuha gjermane për fëmijët e punëtorëve shqiptarë në Gjermani paraqitet si H-Variant, sepse pasi ajo përveç se përdoret në situata formale (shkollë, ente shtetërore, zyre etj.) përdoret edhe në situatat e tjera të komunikimit privat (me bashkëshortin gjerman, fqinjët, miqtë, etj.) dhe me kalimin e kohës vjen në shprehje kërcënimi i gjuhës amtare dhe humbja e saj. Kjo dukuri e humbjes së gjuhës amtare dhe kompetenca jo e plotë e gjuhës së atij shteti ku jeton në linguistikë njihet me termin Semilinglizmi.⁴ Semilingualizmi i referohet fenomenit të gjuhës „gjysmë-gjysmë“, kur folësi nuk flet në mënyrë korrekte asnjërin nga gjuhët. Në një kuptim më të gjerë, termi Semilingualizem (gjysmë-gjuhësor) jo vetëm që përfshin karakteristikat gjuhësore siç është shqiptimi i saktë (me fjalë) ose kuptimi dhe të kuptuarit e një gjuhe, por përfshin të gjitha aftësitë gjuhësore dhe komunikuese të njeriut. Sipas Cummins (1979: 229) Semilingualizmi shpesh lidhet me performancën e dobët në shkollë dhe problemet psiko-sociale. Për shembull, sipas modelit të pragut të dyfishtë të Cummins, mungesa e njohurive të gjuhës së fëmijës mbart me vete rrezikun e gjysmë-gjuhësisë: nëse zhvillimi i gjuhës L1 dhe L2 është i pamjaftueshëm, zhvillimi kognitiv i fëmijës mund të rrezikohet dhe mund të çojë në vështirësi akademike, çrregullimet e sjelljes shoqërore etj. Nga ana tjetër zhvillimi i suksesshëm i dy gjuhëve L1 dhe L2, mund të rezultojë në bilingualizëm të balancuar me pasoja pozitive për zhvillimin kognitiv të individit.

³ Situata e një grupi social (familja, populli, qyteti, regjioni etj.) e cila në një kohë të caktuar e ndjen nevojën e tyre komunikuese çfarëdo arsye qoftë ajo dhe është e lidhur me dy ose më shumë variante gjuhësore (gjuhë, dialekte etj.) rregullisht shërbehet me ndërrimin e roleve quhet diglosi.

⁴ Shih Cummins (1979: 229).

Përzierja e gjuhës dhe kalimi në gjuhën tjetër

Një diferencim i rëndësishëm në lidhje me përdorimin e më shumë se një gjuhë në bashkëveprim është dallimi i përzierjes së fjalëve kundrejt kodit të kalimit (code-switching) në gjuhën tjetër. Kështu që fëmijët që rriten me më shumë se një gjuhë zakonisht përjetojnë një ndarje të rreptë të gjuhëve të ndryshme në jetën e tyre dhe kështu shumica e tyre shpresojnë që të lehtësojnë dallimin mes dy gjuhëve. Megjithatë Zimmer (2004) pyet nëse gjuhët e ndryshme në kontakt me të vërtetë ndërhyjnë me njëra-tjetrën dhe nëse ka ndërhyrje gjuhësore apo siç njihen në linguistikë interferenca gjuhësore. Mu për këtë shkak, për një kohë të gjatë psikolinguistika hulumtonte çështjen se si dy gjuhët janë ruajtur në tru. Sot, kuptohet se termat e të dyja gjuhëve ndonjëherë i përkasin një leksiku të zakonshëm dhe nganjëherë një leksiku të veçantë.

Përzierjet e fjalëve përdoren kur njohuria gjuhësore transferohet nga një gjuhë në tjetrën dhe kjo bëhet në rrafshe të ndryshme të gjuhës. Vetë procesi në gjuhësi quhet 'transfer' kurse rezultati gjuhësor quhet 'interferencë' dhe mund të përdoret në komunikim për arsye të ndryshme. Ndërsa në kodin e përzierjes së gjuhës (Code-Mixing) duke mos qenë në vetëdije ajo ndodh brenda një fjalie dhe varësisht nga situata në të cilën gjendet partneri ajo kalon në gjuhën tjetër. Përzierja e gjuhës së leximit i referohet kur njësitë leksikore krejtësisht të pandryhuara merren nga L1 në L2. Përzierja e fjalëve ndodh si në fushën e marrjes së pakontrolluar dhe të kontrolluar të gjuhës së dytë, ashtu edhe në fazën e saj të hershme. Funkzioni kryesor i përzierjes së gjuhës leksikore është plotësimi i boshllëqeve leksikore nga ana e përdoruesit dhe kjo mund të ndodhë si në gjuhën e folur ashtu dhe në gjuhën e shkruar. Për rrjedhojë, ai përshkruan një proces jo të plotë të kalimit të kodit (për shembull, në deklaratën *Ich bin Loti. Unë jam Loti.*, megjithëse flitet gjermanisht, përmban elemente të gramatikës shqipe, e cila nuk është perceptuar si e gabuar nga folësi në paketën e përgjithshme). Në këtë pikëpamje, duhet të vijë në shprehje pedagogjia e arsimit special e cila ka për detyrë që folësit ti aftësojë ti kuptojnë vështirësitë e mundshme, pasi përzierjet gjuhësore - shpesh shpreh shenjën e kompetencës gjuhësore - gjithashtu mund të jenë një tregues i vështirësive në mësimin e disa gjuhëve. Prandaj është obligim i detyrueshëm i qeverive të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë e tjerë, që të rrisin numrin e mësimdhënësve të gjuhës shqipe në vendet gjermanofolëse, por pse jo edhe në vendet tjera që t'u ofrohet këtyre fëmijëve mësimi i gjuhës

amtare me të vetmin qellim, që mos të vjen deri te asimilimi dhe humbja e identitetit gjuhësor.

Interferenca si burim i gabimeve gjuhësore

Një ndër faktorët pengues që i japin folësit ndjenjën e pasigurisë gjatë të shprehurit me gojë apo me shkrim në dy gjuhë është edhe interferenca gjuhësore. Sipas Rrokaj (2007) cituar nga Sinanaj (2016: 34) me interferencë kuptohet kalimi i një elementi të sistemit të gjuhës A në sistemin e gjuhës B. Këto kalime janë të pranishme në të gjitha gjuhët dhe në të gjitha kohët kur gjuhët vihen në kontakt. Me termin interferencë gjuhësore kuptohet ndërhyrja e një tërësie veprimesh pak a shumë të menduara, qëllimi i të cilave është ndryshimi i kodit gjuhësor ose i kushteve të përdorimit. Ndërhyrja gjuhësore mund të marrë shumë forma dhe mund të orientohet në shumë aspekte gjuhësore. Ky interpretim i interferencës gjuhësore u referohet shkeljeve të normave gjuhësore që nëpërmjet ndikimit të ndërsjellë të dy gjuhëve, si në njërin ashtu edhe në tjetrën vijnë si rezultat i kompetencës gjuhësore. Në rastin konkret të gjuhës shqipe dhe asaj gjermane. Juhász (1980) e përkufizon këtë term si vijon:

“Interferenz (Int.) ist die durch die Beeinflussung von Elementen einer anderen oder der gleichen Sprache verursachte Verletzung einer sprachlichen Norm bzw. der Prozeß dieser Beeinflussung.”⁵

Sipas Juhász (1980: 647) ekzistojnë faktorë të jashtëm dhe të brendshëm gjuhësor që e vështirësojnë përvetësimin e njëres apo tjetres gjuhë dhe për të kapërcyer këtë ndërhyrje (interferencë), fëmijët që flasin dy gjuhë e më tepër duhet të njihen me faktorët e jashtëm të mundshëm që e shkaktojnë interferencën gjuhësore. Në këtë aspekt Ulich (1995: 42) bën diferencimin në mes të prezencës së pozicionit zero gjerm. *Nullstelle* në gjuhë të huaj nga njëra anë dhe në gjuhën amtare nga ana tjetër, meqenëse pozita e zbrazët ose pozita zero është arsyeja e transferimit dhe kështu mund të ndodhin interferenca gjuhësore. Si rezultat të këtyre ndikimeve Hufeisen/Neuner (1999: 27) i përshkruajnë pengesat e tilla si më poshtë: [...] unë kam gjermanishten si gjuhë amtare, anglishten si gjuhë të parë të huaj (1L) dhe frëngjishten kam mësuar si gjuhë të dytë të huaj (2L), kështu që gjermanishtja ndikoi në mësimin e anglishtes, anglishtja ndikoi në mësimin e frëngjishtes, por frëngjishtja ime nuk ndikoi as në gjuhën amtare, as në gjuhën angleze

⁵ Interferenca vjen si rezultat i ndikimit të elementeve të njëres apo të njëjtës gjuhë e cila shkakton shkelje të një norme gjuhësore ose procesit të këtij ndikimi.

[...] dhe kjo ndodh sidomos kur gjuhët janë të lidhura me gjuhën amtare apo me gjuhën tjetër të huaj ose gjuhë të huaj me njëra-tjetrën.

Në procesin gjuhësor të përshkruar më sipër, në shumicën e rasteve, elementët gjuhësorë të gjuhës dominuese do të shfaqen në gjuhën më pak të zhvilluar dhe të dobët, me dallimin ose ngjashmërinë e të dy gjuhëve që janë me rëndësi të madhe (Weinrich (1953). Sipas Kielhofer / Jonekeit (1993) dhe Taeschner (1983) të cituar nga Jedik (2002a) interferenca mund të ndikojë dhe të manifestohet në gjuhën e shkruar dhe të folur në çdo nivel të gjuhës dhe dallon tri lloje të saj:

- (a) interferenca në aspektin fonetik-fonologjik,
- (b) interferenca morfologjike-sintaksore,
- (c) interferenca semantike-leksikore.

Në vijim, le të hedhim një vështrim më të afërt në ndërhyrjen më të zakonshme gjuhësore të fëmijët me gjuhë amtare shqipe gjatë mësimin të gjuhës gjermane në rrafshin morfosintaksor dhe leksik duke e lënë jashtë analizës hulumtuese aspektin fonetiko-fonologjik.

(a) Interferenca gjuhësore në aspektin morfo-sintaksor

Kur flasim për interferencën (ndërhyrjen negative të gjuhës amtare gjatë mësimin të gjuhës gjermane) në nivelin gramatikor, kjo përfshin ndërhyrjen në nivelin morfologjik dhe sintaksor. Morfologjia në mënyrë specifike merret me strukturën e brendshme të fjalëve dhe analizon natyrën dhe formën e saj në mënyrë që të përshkruajë dhe klasifikojë fjalët. Ka dy lloje themelore të morfemave: morfemë leksikore dhe gramatikore. Morfemat leksikore tregojnë kuptimin semantik të fjalës, ndërsa morfemat gramatikore na japin informacion gramatikor si: numri, gjinia ose rasa e emrit në fjali. Sipas Agalliut e të tjerëve (2002: 53) sintaksë quhet tërësia e mënyrave të bashkimit në ligjërim të fjalëve të një gjuhe sipas kuptimit dhe natyrës gramatikore, bashke me marrëdhëniet e vendosura midis njësisive të formuara prej tyre, me rregullsitë përkatëse, për të shprehur mendimet e për t'ua bërë ato të njohura të tjerëve.

Siç thamë edhe më lartë interferencë në aspektin morfosintaksor konsiderohet shkëlqje e parimeve dhe rregullave morfologjike dhe sintaksore të një gjuhe në gjuhën tjetër. Ky lloj i ndërhyrjes, në parim, çon në formimin e fjalive gramatikusht të pasakta. Konstatimi është universal se kategoria gramatikore e gjinisë së emrit është problematike për mësimin e gjuhës gjermane për faktin se në gjermanisht bëhet dallimi në mes të gjinisë gramatikore dhe natyrore të emrave të njerëzve

dhe të kafshëve. Si p.sh. emri *vajzë* në gjuhën shqipe është në gjininë femërore, kurse në gjuhën gjermane në gjininë asnjënjëse *das Mädchen* (Buchholz Oda / Wilfried Fiedler, 1987: 317). Ky fenomen është për shkak të mospërputhjes së gjinisë gramatikore dhe asaj natyrore të emrit në gjuhën gjermane. Por në shqip, gjinia natyrore i përshtatet gjinisë gramatikore kur bëhet fjalë për individët. Prandaj, për fëmijët që e mësojnë gjermanisht tingëllon e palogjikshme emri *vajzë* në gjuhën gjermane të jetë në gjininë asnjënjëse.

Nëse gjinia e emrave në gjuhën gjermane nuk zotërohet mirë, ai vepron si një multiplikator për një gjermanishte të pasaktë. Një gabim në përcaktimin e gjinisë tërheq gabime tjera përgjatë gjithë sistemit të lakimit të emrit, dhe paraqitet me mbaresa të pasakta në rasat e emrit, të mbiemrit dhe të përemrit. Sipas Diehl (2000: 198), kompleksiteti i paradigmes së gjinisë së emrit dhe gabimet interferente që paraqiten të mbiemrat, në pyetjen e parashtruar, se kush mund të përvetësojë gjininë e emrit pa gabime, ajo përgjigjet si më poshtë:

“Die Muttersprachlerinnen und Muttersprachler – und wenige sehr fortgeschrittene L2 – Erwerbende”⁶

Si p.sh.: **Die Tisch ist neu. Der Tisch ist neu. Tryeza është e re.*

**Ich kaufe eine Tisch. Ich kaufe einen Tisch. Unë e blej një tryezë.*

Në shembullin e paraqitur emri *tryezë* në gjuhën shqipe është emër i gjinisë femërore kurse në gjuhën gjermane *der Tisch* është emër i gjinisë mashkullore. Gabime interferente të kësaj natyre janë të pashmangshme gjatë mësimin të gjuhës gjermane. Shembull tjetër karakteristik është fakti kur mbiemri në gjuhën gjermane përdoret si parafjalë emërore atëherë gjinia e emrit neutralizohet si p.sh.:

Sie kam verletzt nach Hause. Ajo erdhi e lënduar në shtëpi.

Er kam verletzt nach Hause. Ai erdhi i lënduar në shtëpi.

Për shkak të ndërhyrjes së gjuhës amtare, nxënësit nuk e vendojnë njëjën para emrit ose e përdorin atë gabimisht, duke filluar nga fakti se i njëjti emër mund të ketë të njëjtën gjini në të dyja gjuhët, për shembull, në gjuhën shqipe: *die Auto, die Tisch, die Mädchen, die Huhn, die Kind* kurse saktësisht në gjuhën gjermane janë: *das Auto, der Tisch, das Mädchen, das Huhn, das Kind* etj.

Në gjuhën gjermane pothuajse të gjitha mbiemrat ndryshojnë formën e tyre nëse ata qëndrojnë para një emër si atribut dhe i nënshtrohen lakimit në rase. Pra, mbiemri duhet të përputhet me emrin, përkatësisht

⁶ Folësit e gjuhës amtare - dhe nxënës shumë të avancuar në gjuhën e dytë (L2).

në gjini, numër dhe në rasë. Mbiemri është pjesë e ligjëratës me gjini të ndryshueshme, kurse emri është pjesë e ligjëratës me disa përjashtime me gjini konstante. Për shkak të përvojës sime personale si mësuese e gjuhës gjermane dhe në bazë të hulumtimit të bërë konstatoj se fëmijët gjatë mësimit të gjuhës gjermane dhe lakimit të mbiemrit në rasi hasin në vështirësi të caktuara ose bëjnë gabime të shpeshta. Gabime të kësaj natyre ndodhin për faktin se nëse para mbiemrit në gjuhën gjermane kemi nyje të caktuar *der, das* ose *die* atëherë mbiemri i takon lakimit të dobët dhe vetë mbiemri në të tri gjinitë merr mbaresën - e, p.sh.: *der kleine Mann, die kleine Frau, das kleine Kind*. Kurse nëse para mbiemrit kemi një të pacaktuar *ein/eine* atëherë mbiemri merr mbaresën përcaktuese të gjinisë si p.sh.: *ein kleiner Mann, eine kleine Frau, ein kleines Kind*. Ky reflektim ndodhë për faktin se në gjuhën shqipe mbiemri e ndryshon njëën sipas rasës, e cila është pjesë e pandashme e tyre. Mbiemrat e nyjshëm, kur janë pjesë përbërëse e kallëzuesit emëror ose përcaktor kallëzuesorë të kryefjalës a të kundrinës, përdoren vetëm në rasën emërore dhe kallëzore si dhe nyja që vihet para mbiemrit në gjuhën shqipe është vetëm në gjininë mashkullore dhe femërore (Agalliu etj. 2002: 167).

Veçoritë dhe dallimet që ekzistojnë në sistemin foljor në mes të gjuhës gjermane dhe asaj shqipe dhe që janë njëkohësisht burim i pashmangshëm i interferencës gjuhësore sipas Iseini (2006) përveç tjerash mund të përmendim:

a) foljet modale në të dy gjuhët dallohen sipas përdorimit dhe ndërtimit të formave të tyre;

b) foljet e ndashme në gjuhën gjermane, që të njëjtat nuk ekzistojnë në gjuhën shqipe;

c) foljet ndihmëse nuk janë të njëjta në të dy gjuhët;

ç) ka dallime në foljet refleksive (vetvetore): 1) në përdorimin e përemrit vetvetor dhe 2) dhe në klasifikimin e tyre (foljet vetvetore në të dy gjuhët nuk përputhen në mes tyre).

d) në të dy gjuhët ka dallime në sistemin zgjedhimor të foljes etj.

Një problem ose vështirësi tjetër, e cila duhet të theksohet është zgjedhimi i foljes. Te zgjedhimi i foljes në gjuhën gjermane nxënësit hasin në dy vështirësi: nga njëra anë folja në infinitiv duhet të korrespondojë me paradigmen e caktuar përmes së cilës folja është e lidhur me vetën, numrin, mënyrën, kohën dhe diatezën, kurse nga ana tjetër nxënësit duhet të bëjnë dallimin e foljeve kalimtare (transitive) dhe

foljeve jokalimtare (intransitive) që të mund në mënyrë korrekte të aplikojë flektimin e tyre.

b) Interferenca gjuhësore në aspektin leksiko-semantik

Në thelb ekzistojnë dy mundësi të tilla se si shfaqen interferencat gjuhësore në aspektin leksiko-semantik. Në aspektin e parë bëjnë pjesë fjalët të cilat për nga forma shfaqen identike si në gjuhën gjermane ashtu edhe në gjuhën shqipe, por kanë kuptim tjetër. Kështu, kur ne kemi një identitet formal të leksemave në gjuhën e synuar dhe në gjuhën amtare, d.m.th, forma identike e leksemës, theksit dhe strukturës grafike kurse përmbajtja semantike është e ndryshme, në shkencën e gjuhësisë këto njihen si çiftet të rreme ose *'faux amis'*.

Si shembull për këtë fenomen mund të marrim fjalën 'konkurs'. Edhe pse leksema 'konkurs' shkruhet dhe shqiptohet njësoj si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën gjermane ajo ndryshon për nga kuptimi semantik i saj. Në gjuhën shqipe leksema 'konkurs' ka kuptimin kur një institucion shtetëror apo firmë private shpallë konkurs për një vend pune, por e kundërta ndodh në gjuhën gjermane sepse leksema *'Konkurs'* në kuptimin e saj semantik ka të bëjë kur një firmë bankroton apo falimenton⁷. Prandaj në gjuhën shqipe fjalës konkurs i përgjigjet fjala *'Stellenausschreibung'* (shq. shpallje për vend pune).

(1) *In seiner Firma gibt es gerade eine Stellenausschreibung.*
Tani ekziston një konkurs në kompaninë e tij.

(2) *Die Firma meines Vaters hat schon Konkurs angemeldet.*
Kompania e babait tim ka paraqitur tashmë falimentimin.

Si shembull tjetër do cekim fjalën absolvent gjermanisht *'Absolvent'*, që në gjermanisht ka këtë kuptim: një person ose dikush që arsimimin e caktuar e ka përfunduar me sukses⁸ (shih Duden-Online) kurse në gjuhën shqipe fjala 'absolvent' do të thotë dikush që është në vitin e fundit të studimeve dhe që ende nuk ka përfunduar me studimet.

Përveç interferencës gjuhësore që paraqitet te çiftet e rrejshme, gabimet interferente shfaqen kur ekuivalenca semantike e një lekseme pjesërisht ose nuk përshtatet ose manifestohet me numra të ndryshëm leksemash në L1 dhe L2. Kjo është e njohur në shkencën e gjuhësisë si

⁷ Duden Online - Ndërprerja e të gjitha pagesave të një kompanie për shkak të falimentimit. (<https://www.duden.de/rechtschreibung/Konkurs>; shikuar më 20.03.2018).

⁸ Duden Online - dikush që ka përfunduar me sukses arsimin e caktuar në një shkollë. (<https://www.duden.de/suchen/dudenonline/absolvent>; shikuar më 20.03.2018).

një diferencim leksik apo diversifikim. Ky fakt çon në fusha asimetrike dhe të ndryshme të rëndësisë dhe kuptimit të fjalës në L1 dhe L2 dhe fëmijët (por edhe të rriturit që nuk e zotërojnë gjuhën e synuar) mund të keqinterpretojnë elementet e L1 dhe L2 që konsiderojnë se janë identike në përmbajtje. Ky fenomen është i theksuar te gjuha gjermane që është ndryshe nga gjuha shqipe, sepse foljet në gjuhën gjermane përcaktojnë saktësisht llojin e veprimit përmes prefiksit të tyre. Si p.sh.: *abstellen, umstellen, anstellen, ausstellen, einstellen, freistellen* e tjerë. Këta shembuj tregojnë qartë vështirësitë e mëdha me të cilat përballen nxënësit kur mësojnë foljet me prefiks të ndryshëm që ndryshojnë kuptimin e fjalëve.

Përfundime dhe konkluzione

Ky punim paraqet një analizë kontrastive të përdorimit të gjuhës gjermane dhe shqipe si rezultat i interferencës gjuhësore të këtyre dy sistemeve gjuhësore.

Qëllimi i hulumtimit në këtë punim ishte përshkrimi dhe analiza e gabimeve morfo-sintaksore dhe leksiko-semantike nën ndikimin e interferencës gjuhësore gjatë mësimit të gjuhës gjermane te fëmijët e punëtorëve shqiptar që kanë lindur dhe janë rritur atje. Në thelb, fëmijët përpiqen ti shmangin gabimet, ose në disa raste ata kanë probleme për ti dalluar ato në përdorimin e duhur, që rezulton ndër të tjera në dallime të konsiderueshme ndërmjet këtyre dy sistemeve gjuhësore, veçanërisht nëse fëmijët janë në fazën fillestare të mësimit të gjuhës gjermane dhe ende nuk kanë njohuri precize dhe të sakta se si dhe kur duhet ti aplikojnë rregullat e ndërlikuara të gramatikës. Duhet theksuar se sipas hulumtimeve të deritanishme për përcaktimin e definicionit gjuhë amtare ende kemi mospërputhje të mendimeve të linguistëve të ndryshëm rreth asaj, çka nënkuptojmë me termin gjuhë amtare. Potenciali i kuptimit të këtij definicioni përfshin përveç gjuhës së folur më parë, gjuha që folësi më së miri e zotëron (kompetenca) ose që ai/ajo pëlqen të flasë (preferencë) ose me të cilën ai/ajo bashkëpunon me një përkatësi kulturore e që është identitet. Interferenca gjuhësore mund të ndodh dhe anasjelltas, kështu që gjuha e huaj ndikon në gjuhën amtare. Një shembull i tillë është rasti me mërgimtarët tanë që jetojnë prej kohësh jashtë vendit dhe duke folur në një gjuhë të huaj bëjnë gabimet interferente nga gjuha amtare në gjuhën e huaj. Gabime të tilla ndërhyrjeje quhen 'ndërhyrje prapavepruese'.

Pra, ngel pyetje e pa përfunduar çështja e dimensionit të gjuhës amtare në reflektimin e biografive gjuhësore dygjuhëshe. Si përfundim, mund të themi se ky punim mund të shërbej si nxitje dhe motivim për hulumtime të kësaj natyre me temë më të zgjeruara dhe më të thellë për t'i shërbyer studimeve tjera.

Conclusion

This paper presents a contrastive analysis of the use of German and Albanian as a result of the linguistic interferences of these two language systems.

The purpose of the research in this paper was to describe and analyze morpho-syntax and lexical-semantic errors under the influence of language interference during German language teaching in the children of Albanian workers who were born and raised there. In essence, children try to avoid mistakes or in some cases they have problems to distinguish them in proper use, resulting, among other things, in significant differences between these two language systems, especially if children are in the initial stage of learning German language and still have no precise knowledge of how and when to apply complicated rules of grammar. It should be emphasized that according to the relevant research to determine the native language definition we still have discrepancies in the opinions of different linguists about what we mean by the term mother tongue. The potential for understanding this definition includes, in addition to the language spoken before, the language the person best speaks or the one he / she likes to speak (preference) or with which he or she cooperates with a cultural affiliation is an identity. Language interference can occur and vice versa, so foreign language affects your mother tongue. One such example is the case with our migrants who have long lived abroad and while speaking in a foreign language they make interfering mistakes from their mother tongue in a foreign language. Such interference errors are called retroactive intervention'.

So, the question of the dimension of mother tongue in the reflection of bilingual biographies remains unanswered. Finally, we can say that this paper could serve as an incentive and motivation for research of this nature with a deeper subject to serve other studies.

Literatura

Agalliu, Fatmir/Angoni Engjëll (2002): *Gramtika e gjuhës shqipe I*. Vëllimi I Morfologjia. Tiranë: Botimi i Akademisë së Shkencave.

Ammon, Ulrich (2000): *Die Rolle des Deutschen in Europa*. In: Gardt, A. (Hrsg.), (471 – 494).

Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried (1987): *Albanische Grammatik*. Leipzig: Verlag Enzyklopädie.

Cummins, Jim (1979): *Linguistic interdependence and the educational development of bilingual children*. In: Review of Educational Research 49, (222-251).

Diehl, Erika (2000): *Grammatikunterricht: alle für der Katz? Untersuchungen zum Zweitspracherwerb Deutsch*. Tübingen: Niemeyer.

Dittmar, Norbert (1980): *Soziolinguistik. Exemplarische und kritische Darstellung ihrer Theori, Empirie und Anwendung*. Königstein/Ts.: Atheneum.

Duden-www: *Wörterbuch Duden online* (<http://www.duden.de/rechtschreibung/Uebersetzung>; 25.1.2015).

Duden-www: *Wörterbuch Duden online* (<https://www.duden.de/suchen/dudenonline/absolvent>; shikuar më 20.03.2018).

Lüdi, Georges/Py, Bernard (1984): *Zweisprachig durch Migration. Einführung in die Erforschung der Mehrsprachigkeit am Beispiel zweier Zuwanderergruppen in Neuenburg (Schweiz)*. Tübingen: Max Niemeyer Verlag.

Peterson, John (2015): *Sprache und Migration*. Heidelberg: Winter.

Rrokaj, Shezai (2007): *Çështje të gjuhës shqipe I, Dy çështje për mësimdhënien e gjuhës shqipe në shkollë*. Tiranë: Albatros.

Sinanaj, Valbona (2016): *Analizë krahasuese e sistemeve fonologjike të shqipes dhe të italishtes në ligjerimin e folësve shqiptar*. Universiteti Tiranë, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës Shqipe. Doktorat. (<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2016/12/PUNIM-PER-GRADEN-DR-I-SHKENCAVE-V.SINANAJ.pdf>; 20.03.2017).

Uhlich, Gerda (1995): *Immer wieder Interferenz(fehler) im Fremdsprachenunterricht*. In: Handwerker (Hrsg.) (S. 225-238).